72. Dosje nr. 172, "Relacion për propozimin agjent me material kompromentues", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
73. Dosje nr. 174, "Relacion mbi agjentin në arrati N. Ç. me pseudonimin I. S. nga Kruja", me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
74. Dosje nr. 175, "Relacion mbi tendencat e arratisjes që nxiten nga të riatdhesuarit e ardhur nga vendet kapitaliste", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
75. Dosje nr. 178, "Relacion mbi zbatimin e direktivës për agjiturën e përpunimet nga Dega IX", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
76. Dosje nr. 179, "Relacion mbi lidhjet e të arratisurit F. Z. nga Kuçi i Vlorës dhe lajmet rreth tij", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
77. Dosje nr. 183, "Vendet e mundshme ku mund të zbarkojnë parashutistat që dërgohen nga zbulimet armike diversante", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
78. Dosje nr. 189, "Akt ndihme e kontrolli dhënë sektorit të Bandave në Degën e Punëve të Brendshme Korçë", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
79. Dosje nr. 192, "Fashikull i kërkimit të bandës së K. D. nga Përmeti, dokumente biografike, plane masash etj", me 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1962.
80. Dosje nr. 193, "Fashikull i përgjithshëm i M. Z., lidhje me rëndësi e diversantit N. Sh. nga Puka", me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I. Bandat. Viti 1962.
81. Dosje nr. 194, "Raporte dhe analiza për vitin 1963 të Degës së Bandave", me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I. Bandat. Viti 1963.

82. Dosje nr. 195, "Pasqyrë statistikore mbi gjendjen e bandave të armatosura në vitet 1961-1963 si dhe rezultatet e luftës kundër bandave nga Çlirimi deri 1963", me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
83. Dosje nr. 196, "Buletin i Degës së Bandave mbi hyrjet e diversantëve në vendin tonë dhe statistika për vitet 1963-1964", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
84. Dosje nr. 197, "Detyrat vjetore të Sektorit të Bandave për vitin 1963", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
85. Dosje nr. 198, "Relacion mbi problemet në rrethet Korçë, Pogradec, Kolonjë", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
86. Dosje nr. 200, "Relacion mbi grupet e armatosura që lëvizin në shtete të ndryshme dhe janë grumbulluar në Jugosllavi", me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I. Bandat. Viti 1963.
87. Dosje nr. 204, "Përshkrimi i të dhënave agjenturiale në ngarkim të H. S., nga Shishtaveci i Kukësit", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
88. Dosje nr. 205, "Relacion mbi arratisjet gjatë vitit 1963 dhe statistikat përkatëse", me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
89. Dosje nr. 206, "Relacion mbi agjaturën në drejtim të bandave", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
90. Dosje nr. 208, "Relacion përmbledhës mbi të arratisurit kundër vendit", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
91. Dosje nr. 211, "Relacion mbi vërejtjet e bëra në analizat e rretheve lidhur me letrën e Ministrit", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
92. Dosje nr. 212, "Raport propozimi për shpërblimin e b.p. "Dushku" Gj. C.", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
93. Dosje nr. 213, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Pogradec", me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
94. Dosje nr. 214, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Gramsh", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
95. Dosje nr. 215, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Librazhd", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
96. Dosje nr. 216, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Skrapar", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
97. Dosje nr. 217, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Lezhë", me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
98. Dosje nr. 218, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Korçë", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
99. Dosje nr. 220, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Dibër", me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
100. Dosje nr. 221, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Durrës", me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
101. Dosje nr. 222, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Shkodër", me 4 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I. Bandat. Viti 1963.

102. Dosje nr. 224, "Akte kontroll e ndihme në Degën e Punëve të Brendshme Kukës", me 38 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Tepër Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Bandat. Viti 1963.
103. Dosje nr. 566, "Për disa të dhëna për futjen e studentëve në ambasadat e huaja dhe organizimin e demokratëve". Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria I. Viti 1990.

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me Vendim nr. 10, datë 02.06.2021**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me Vendimin nr. 10, datë 02.06.2021, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

#### **II. Deklasifikim i plotë i dosjeve:**

1. Procesverbal nr. prot. 62/5, datë 15.02.1989 mbi dorëzimin e materialeve operative të ndjekjes së krimeve të Rajonit të Policisë nr. 8, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit është "A. Rez. Personal".
2. Urdhër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 292/1 Prot., datë 14.10.1986 "Mbi dërgimin e Urdhërit të Ministrit të Punëve të Brendshme për shpërndarjen e direktives mbi funksionet dhe detyrat e Forcave të Ministrisë së Punëve të Brendshme për kohë lufte", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret i Rëndësisë Veçantë".
3. Vendim i shefit të policisë së rrethit "Për heqjen nga përpunimi paraprak të Violeta Mullarajt dhe veçimin e dosjes për asgjësim", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret".
4. Libër i dorëzimit të dokumenteve nr. 24, me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është "Sekret". Dokumenti daton në vitet 1987 - 28.06.1991.
5. Dosje nr. 18, Relacion mbi keqinterpretimet dhe shtrembërime në urdhërin e kryeministrisë që bën fjalë për spastimin e aparatit shtetëror nga elementë të pa dëshirueshëm, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
6. Dosje nr. 17, relacion drejtuar udhëheqjes së Partisë së Shtetit mbi vërtetimin e shifrave mbi gjendjen aktuale dhe industriale të Shqipërisë, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
7. Dosje nr. 16, relacion dërguar kryetarit të Këshillit të Ministrave mbi krimet e kryera në sektorin e ekonomisë socialiste gjatë vitit 1955 me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
8. Dosje nr. 15, Relacion mbi masat e organeve të Sigurimit të Shtetit në lidhje me disa probleme ekonomike të rëndësishme, me 2 (dy) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
9. Dosje nr. 21, Relacion drejtuar udhëheqjes së Partisë mbi qëndrimin armiqësor të specialistëve të huaj

- Polak, Hungarez në vendin tonë, me 5 (pesë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
10. Dosje nr. 113, Inventari i dosjes dhe informacione dërguar udhëheqjes së partisë e Shtetit mbi disa të meta e mangësi në sektorin e industrisë së naftës, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  11. Dosje nr. 114, Inventari i brendshëm i dosjes, informacione dërguar udhëheqjes së Partisë e Shtetit mbi dëmtimet e vjedhjet e pasurisë socialiste, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  12. Dosje nr. 110/2, Raport mbi karakteristikat kryesore të veprimtarisë armiqsore e keqbërëse në drejtim të ekonomisë gjatë vitit 1973, rezultatet e organeve kundër kësaj veprimtarie dhe detyrat për vitin 1974, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  13. Dosje nr. 110/3, Informacione mbi rolin dhe detyrat e agjenturës së profilizuar për zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë armiqsore e keqbërëse në drejtim të ekonomisë. me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  14. Dosje nr. 100/1, Inventari i brendshëm i dosjes, informacione mbi zbatimin e detyrave për mbrojtjen e ekonomisë socialiste, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  15. Dosje nr. 100, Relacion mbi kriteret e hetuesisë në sektorin ekonomik të Uzinave mekanike, me 1 (një) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  16. Dosje nr. 91, Raport vjetor mbi veprimtarinë armiqsore të elementit armik në sektorin ekonomik dhe pasqyrat statistikore mbi krimet në ekonomi, përpunimet dhe agjencia, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963-1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  17. Dosje nr. 55, Pasqyra statistikore e përpunimeve 2-A dhe 2-B të agjenturës dhe të arrestimeve, me 6 (gjashtë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  18. Dosje nr. 49, Pasqyra statistikore e përpunimeve 2-A dhe 2-B si dhe pasqyrë e agjenturës dhe pasqyrë statistikore e arrestimeve, me 10 (dhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1955. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  19. Dosje nr. 98, Urdhri i Ministrit të Punëve të Brëndshme mbi shpërblimin nga fondi i veçantë të Hysen Shehut dhe relacion mbi këtë problem, me 4 (katër) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1970. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
  20. Dosje nr. 96/1, Analizë mbi punën e kartotekës, si dhe informacion mbi evidencën operative të kontigjentëve armike të Shtetit, me 20 (njëzet) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  21. Dosje nr. 96/2, Akt-kontroll dhe informacion mbi kontrollin e llogarisë të fondit të veçantë në Drejtorinë e Zbulimit, me 9 (nëntë) fletë Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  22. Dosje nr. 93/1, Informacion mbi gjëndjen e Arkivit dhe masat që propozohet për përmirsimin e kushteve të tij, me 4 (katër) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1968. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  23. Dosje nr. 85/2, Regjistër emëror i agjenturës të sektorëve operativë të policisë popullore për periudhën 1952-1965, me 80 (tetëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
  24. Dosje nr. 85/1, Regjistër emëror i personave në përpunim për llogari të sektorit operativ të policisë, me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

25. Dosje nr. 76, Statistika vjetore mbi agjencurën, përpunimet 2-A dhe 2-B, me 8 (tetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1961. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
26. Dosje nr. 75, Statistika vjetore mbi agjencurën, përpunimet 2-A dhe 2-B, dhe relacion analitik mbi statistikat, me 14 (katëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
27. Dosje nr. 68, Statistika mbi agjencurën, përpunimet 2-A dhe 2-B dhe arrestimet, me 7 (shtatë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
28. Dosje nr. 108/5, Vlersime të Komisionit Të Ekspertizës për asgjësim dokumentesh, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1971. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
29. Dosje nr. 102/2, Vlersime të Komisionit Të Ekspertizës për asgjësim dokumentesh, me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1965-1970. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
30. Dosje nr. 108/4, Informacion mbi një të burgosur Muharrem Kaloshi dhe disa dobësi në drejtim të kontroll-rezervimit, me 5 (pesë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1971. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
31. Dosje nr. 12, Informacione mbi gjëndjen ekonomike në Greqi, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1954. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
32. Dosje nr. 51, Listë dhe fotografi të bandës dhe thyesave të kufirit, me 3 (tre) fletë dhe 15 foto në zarf. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
33. Dosje nr. 94, Relacion mbi disa shkelje të rënda nga punojës të organeve të kundërzbulimit, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
34. Dosje nr. 92, Informacione mbi tërheqjen në bashkëpunim të kandidatëve ushtarë, mbi goditjen e grupit 'Kënetë', mbi disa ngjarje negative në doganën e Morinës, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1973. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
35. Dosje nr. 43, Relacione mbi personat që implikohen në procesin e të pandehurve L. G., P. B., D. N. etj, me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
36. Dosje nr. 86, Relacione të Ministrisë dërguar Komitetit Qëndror të Partisë mbi veprimtarinë armiqsore të elementit anti parti dhe personat që implikohen si D. N., L. G. etj, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1956. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

## **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 11, datë 04.06.2021**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara "sekret shtetëror", me Vendimin nr. 11, datë 04.06.2021, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

#### **I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

1. Fashikull verifikimi nr. 323, në ngarkim të A. H., me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondi Operativ.
2. Dosje pune dhe personale nr. 12611, në ngarkim të S. B., me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

#### **KRYETARE E KDZH-së**

**Gentiana Sula**





## VEPRIMTARI

TË AUTORITETIT PËR  
INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E  
ISH SIGURIMIT TË SHTETIT  
PËR PERIUDHËN MAJ-QERSHOR  
2021

## Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit mes AIDSSH dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë

Në mjediset e MASR u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit.

Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërmjet MASR dhe AIDSSH në kuadër të zbatimit të politikave të përbashkëta mbështetëse, ku përfshihet periudha e komunizmit, në vitet '44-'91, bashkëpunimi në fushën e projekteve me fokus njohjen dhe përkujtimin e vlerave të brezat e rinj, nëpërmjet studimit, përfshirjes dhe pjesëmarrjes në vende të kujtesës për ngjarje e vende që dëshmojnë histori dhe realitete të 1944-1991, nga krimet e komunizmit, të funksionet e ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri; bashkëpunimi në fushën e zhvillimit të programeve të përbashkëta për mësuesit e historisë, tekst shkruarit e historisë dhe të kurrikulave shkollore me dokumentacionin që administron AIDSSH.



“Në këtë marrëveshje me MASR, AIDSSH merr përsipër të krijojë kushtet e nevojshme për t’u bërë qendër e vizitueshme studimore për nxënësit dhe studentët, në mjediset që mund të jenë në interesin e tyre dhe të vërë në dispozicion: arkivin e Autoritetit; sallën e leximit, bibliotekën, botimet e institucionit; ekspozitat tematike për të shkuarën komuniste; zhvillimin e projekteve studimore të së shkuarës, me mjediset dhe me burimet e AIDSSH-së dhe partnerëve” u shpreh Kryetarja e Autoritetit, znj. Sula.

Sipas znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit, “marrëveshja nxit dhe mbështet realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe të edukimit qytetar për demokraci, ku do të kontribuohet në fushën e zhvillimit të programeve të përbashkëta për: mësuesit e historisë; tekstshkruarit e historisë dhe të programeve shkollore; programshkruarit e lëndëve shkollore: histori, letërsi, gjuhësi, biologji, kimi, qytetari, gjeografi, etj., si dhe për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta që kanë në fokus krimet e komunizmit në Shqipëri dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimit i Shtetit, me qëllim njohjen dhe edukimin e nxënësve dhe studentëve me historinë.”





## Konferenca “Dizinformimi në kujtesën politike: praktika dhe format e parandalimit”

Më 13 maj u zhvillua konferenca ndërkombëtare: “Dizinformimi në kujtesën politike: praktika dhe format e parandalimit”, e organizuar nga Rrjeti European i Kujtesës dhe Solidaritetit.

Kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula, anëtare vëzhguese e Bordit Këshillues në ENRS, moderoi bashkë me dr. Stefanczyk, diskutimet në panelin “Strategjitë ndërkombëtare/europiane për parandalimin e dizinformimit”. Në konferencë u trajtuan çështje të lidhura me etikën, të vërtetën dhe dizinformimin, me kujtesën politike, qasjet e ndryshme historike dhe regjimin totalitar. U diskutua rreth rolit të medias dhe edukimit, dhe kryesisht te metodat, teknikat dhe aktorët që çojnë në dizinformim dhe shmangien e së vërtetës.

Konferenca theksoi nevojën për një bashkëpunim të intensifikuar shkencor dhe profesional për të mbrojtur faktet historike dhe aktuale kundër sfidave të propagandës politike.



## Rezoluta e Autoritetit në Kuvend

Më 24 maj, AIDSSH raportoi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut përmbushjen e detyrimeve dhe rekomandimeve të përcaktuara në rezolutën e vitit 2020.

## Të pagjeturit në Shkodër dhe Malësi të Madhe

Më 27-28 maj, AIDSSH zhvilloi një vizitë në Shkodër dhe në Malësi të madhe, në kuadër të projektit të ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste”, i mbështetur nga Bashkimi European.



Më 27 maj, ekipi i Autoritetit dhe bashkëpunëtorëve të tij, Shoqata e ish-të Përndjekurve të Shkodrës dhe ajo e ish-të Përndjekurve të Malësisë së Madhe zhvilluan një udhëtim në terren, në zonën e Mbishkodrës, atje ku u organizua kryengritja e parë antikomuniste në 1945 dhe Sigurimi i Shtetit u angazhua fuqimisht, që vitet e para të vendosjes së sistemit deri në përfundim të tij.

Zona kufitare e Hotit, ku ishte vendosur kloni dhe më sipër, deri në Vermosh, mbikëqyrej nga një strukturë e tërë survejimi. Sot gjurmët e tyre nuk janë më, por është mbresëlënëse afërsia me rrugën e kufirit izolues, ku mbetën shumë të rinj, dhe ku u fikën planet për të ardhmen e shumë familjeve shkodrane e malësore.

Njohja në terren e vendeve të rëndësishme të kujtesës, ku mund të organizohen udhëtime me të rinj e shkolëtarë, për njohjen me vendet ku mbetën apo kaluan ato që tentuan arratisjen nga burgu i madh, i parapriu aktivitetit të parë për të zhdukurit, që AIDSSH organizoi në bashkëpunim me ICMP dhe pushtetin lokal në Shkodër më 28 maj, pranë Muzeut Historik të Shkodrës.



Autoriteti prezantoi për qytetarët shkodranë ekspozitën “E shkuara e pakryer”, me profile të të pagjeturve të komunizmit, dëshmi të mbledhura nga familjarë të të pagjeturve në kuadër të projektit dhe materiale të përzgjedhura nga hulumtimi në historikët e Sigurimit.

Muzeu Historik i Shkodrës, - shtëpia e Oso Kukës ku sot është vendosur biblioteka e Arshi Pipës, - mirëpriti familjarë të të pagjeturve të komunizmit në zonën e Shkodrës e Malësisë së Madhe; shoqata të të përndjekurve dhe kujtesës: Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë të Shkodrës, Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë të Malësisë së Madhe, Shoqata Muzeumi i burgut të Spaçit, Shoqata “Drejtësi dhe Paqe”, përfaqësues të grupeve të interesit, të komuniteteve fetare, aktorë të shoqërisë civile, gazetarë dhe të rinj

Znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit, theksoi në fjalën e hapjes se “institucionet duhet të veprojnë dhe familjarëve duhet t’u respektohet e drejta për të nderuar njerëzish të afërmit e tyre, ende të pagjetur”.

Z. Simon Mirakaj, anëtar i Autoritetit, vuri në dukje detyrimin e shoqërisë ndaj të zhdukurve, të cilët, ende sot vazhdojnë të mbeten peng i procedurave të stërzgjatura ligjore, pa u dhënë mundësi familjarëve t’i nderojnë në vendprehjen e fundit.



Udhërrëfyese për familjarët e të zhdukurve në komunizëm u prezantua nga Rovena Voda, në komunikim publik me të interesuarit, para finalizimit të tij dhe shpërndarjes për të interesuarit. Znj. Voda bëri të qartë funksionet e institucioneve në proces dhe hapat që duhet të ndjekin familjarët.

Z. Niko Brahimaj, drejtues i Policisë Rajonale Shkodër, i njohur që më herët me procesin dhe aktiv në takim, mori përsipër përgjegjësitë e Policisë së Shtetit në protokolle, sipas ligjit dhe udhëzuesit dhe iu përgjigj pyetjeve të të pranishmëve.



Në vijim, kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi parashtroi qëndrimin e vet ndaj kauzës, duke u angazhuar për mbështetje të zhvarrimit dhe procedurave të identifikimit të viktimave të raportuara dhe paraqitur gatishmëri për fillim sa më të shpejtë të procesit.

Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, z. Vincenzo Del Monaco, për herë të parë në Shkodër, iu përgjigj kërkesave të të pranishmëve për njohje dhe mbështetje ndërkombëtare të procesit, përfshirje të aktorëve në të dhe marrje përgjegjësisë.

Takimi vijoi me moderimin e Ardita Repishtit të AIDSSH, me diskutime të familjarëve shkodranë dhe malësorë, që bënë prezent shqetësimin shumëvjeçar për gjetjen e të afërmeve të tyre dhe pasivitetin e institucioneve. Z. Luigj Ndou, përfaqësues i ICMP për Shqipërinë, theksoi rëndësinë e një procesi të rregullt dhe brenda standardeve ndërkombëtare. Gjatë bisedës u shpërndanë draftudhëzues për të pranishmit dhe u plotësuan formularë nga familjarët e të zhdukurve.

Hapi i radhës në Shkodër do të jetë në terren, në vendvarrimet e raportuara, për veprim konkret e të koordinuar të institucioneve.



### **Raportimi në Kuvend i veprimtarisë së AIDSSH**

Më 3 qershor Kryetarja Gentiana Sula, raportoi në Kuvendin e Shqipërisë për veprimtarinë e AIDSSH-së gjatë vitit 2020.

### **AIDSSH në media**

Më 8 qershor, kryetarja e AIDSSH znj. Gentiana Sula dhe anëtari z. Simon Mirakaj u ftuan në emisionin Spotlight, në Vizion +, moderuar nga Alban Dudushi, për të folur rreth punës së Autoritetit dhe raportimit në Kuvend për vitin 2020, i cili ngjalli interes në parlament dhe në publik.

Diskutimi u përqendrua në vettingun në drejtësi, polici dhe politikë, hapja e dosjeve individuale dhe atyre me interes publik, zbardhja e ngjarjeve të rëndësishme të së shkuarës, hulumtimi shkencor, studimet multidisiplinare, çështja e të pagjeturve të komunizmit dhe dialogu për demokraci, si përballje me të shkuarën e afër.



### **Prezantohen botimet mbi mendimin politik të së majtës së përndjekur**

Më 24 qershor 2021, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Fondacioni Friedrich Ebert në Tiranë prezantuan botimet mbi Mendimin politik të së majtës shqiptare, në mjediset e jashtme të Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”.

Studimet e plota, versioni i shkurtuar dhe ai në gjuhën angleze u shpërndanë për studiuesit, familjarët, përfaqësuesit e institucioneve publike, organizatave të të drejtave të njeriut, trupit diplomatik dhe të rinjtë e interesuar.



Prej më shumë se një viti, AIDSSH dhe FES u bënë bashkë në një projekt serioz dhe sfidues, për të ndriçuar këtë aspekt të historisë sonë të afërt. Dhjetë intelektualë të mirënjohur, filozofë, gazetarë, mendimtarë e përkthyes, shkrimtarë e njohës shumë të mirë të dinamikave në vend e jashtë tij, u trajtuan me profesionalizëm dhe në dritën e dokumenteve historike.



4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare profileve të përzgjedhura, duke riskuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX. *Sejfulla Malëshova, Konstandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Luarasi, Petro Marko, Xhavit Qesja, Isuf Keçi, Zef Mala* e të tjerë janë personalitete që u frymëzuan nga aspiratat për drejtësi shoqërore dhe punuan për ta ngritur e formësuar të majtën në vend, si e majtë europiane.



Projekti dhe rezultatet e tij u prezantuan nga kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula dhe përfaqësuesja e FES Shqipëri, znj. Jonida Smaja.

Prof. Sonila Boçi, drejtuese e ekipit të studiuesve bëri një paraqitje të figurave të përzgjedhura dhe metodologjisë së përdorur. Me radhë, studiuesit Ana Lalaj, Dorian Koçi, Edon Qesari dhe Ilir Kalemaj folën për personalitetet e trajtuara dhe sfidat në zbrëthimin e ngjyrimeve të së majtës.

Takimi u moderua nga Ardita Repishti e AIDSSH.



Versioni i plotë i studimeve, ai i shkurtuar, me tekste të Fatmira Nikollit dhe versioni në anglisht, për lexuesin e huaj dhe jashtë vendit, të prezantuar me grafikën e Henrik Lezit, mund të shfletohen edhe online në faqen [aidssh - Issuu](http://aidssh-issuu.dosjeve.gov.al) dhe Botime AIDSSH – Autoriteti i Dosjeve ([autoritetidosjeve.gov.al](http://autoritetidosjeve.gov.al)).

AIDSSH po punon për studime të ngjashme të së djathtës shqiptare të përndjekur, në bashkëpunim me historianë, familjarë e studiues, mbi bazën e dokumenteve arkivore. Dhjetëra dosje janë deklasifikuar dhe një pjesë e mirë janë vënë në dispozicion, mes të cilëve, ato të Ballit Kombëtar, Legalitetit, Grupi të deputetëve opozitarë, Partisë Bashkimi Demokrat, Komitetit Shqipëria e lirë, Bllokut Independent dhe Ali Këlcyrës, Kadri Cakranit, Selman Rizës e shumë të tjerëve, që pritet të ridimensionohen në dritën e studimeve shumëdisiplinare.

Lufta e Dytë Botërore formësoi rrymat kryesore, e majta komuniste, me shumicë individësh liberalë dhe socialdemokratë, dhe e djathta konservatore republikane, e mishëruar me Ballin Kombëtar, i cili gjithashtu kishte mjaft rryma brenda tij me filozofi të ndryshme politike, por gjithnjë kombëtariste dhe antikomuniste. Gjatë luftës u kristalizuan edhe dy formacione të rëndësishme politike si monarkistët, por edhe nacionalistët kombëtaristë, që vendosën të merrnin rol aktiv në ekzekutiv. Të gjitha këto rryma të ndryshme politike bashkoheshin në qëndrimin kundër komunizmit, por ndaheshin në shumë aspekte të tjera, që kishin të bënin më shumë me ndasitë e vjetra politike që nisnin nga themelimi i shtetit shqiptar.

Gjatë luftës pati edhe lëvizje të pavarura lokale antikomuniste, si Lëvizja Kryeziu, ajo e Muharrem Bajraktarit apo e Markagjonit.

Botimet mbi të majtën dhe të djathtën janë ftesë për reflektim dhe mundësi që shoqëria e të rinjtë të njihen me individë me identitet politik të qartë, të përcaktuar dhe të dallueshëm, pjesë e trashëgimisë historike të Shqipërisë.



## Prioritet të pagjeturit e komunizmit dhe ish-të përndjekurit politikë



Më 8 qershor, Drejtori i Pagesave dhe Dëmshpërblimeve në Ministrinë e Financave, z. Artemon Cukalla, u prit në AIDSSH nga Kryetarja, znj. Gentiana Sula, z. Simon Mirakaj, Anëtar, z. Selami Zalli, Drejtor I Informacionit dhe z. Agron Hoxha, specialist për të zhdukurit. Probleme thelbësore që kanë të bëjnë me të përndjekurit politikë dhe dëmshpërblimet e tyre, dokumentacionin e kërkuar nga institucionet dhe kohën e dhënies së kësteve ishin pjesë e diskutimeve. Autoriteti i propozoi z. Cukalla që të shihen mundësitë për trajtimin me prioritet të dosjeve të të pagjeturve, të pushkatuarve, dëmshpërblimet e tyre. Po ashtu, rritje buxheti për ish-të përndjekurit politikë.

Problem i rëndësishëm me të cilin hasen ish-të përndjekurit sot dhe trashëgimtarët e tyre, janë edhe dosjet e të internuarve, në shumë raste me mungesa në dokumentacion. U propozua që dosjet e të internuarve të mund të kalohen përmes bashkëpunimit ndërinstytucional dhe VKM-së përkatëse, që ndihmon plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe përshpejton dhënien e dëmshpërblimeve të internuarve në kampe me tela me gjemba.

Po ashtu, do të përgatitet një propozim për pensionet e të internuarve, ku sugjerohet edhe rregullimi i kuadrit ligjor përkatës, që u mundëson të ardhura të internuarve në diktaturë.

Autoriteti e ka pjesë të punës së përditshme shërbimin e dokumentacionit ish-të përndjekurve dhe familjarëve të tyre, për arsye pensioni, dëmshpërblimi, etj. Përballja e përditshme me qytetarët dhe problematikat e hasura prej tyre në vite nxitën një takim të tillë, me dëshirën e lehtësimit të procedurave dhe shkurtimit të kohës së përfitimit të dëmshpërblimit një kategorie shoqërore të dinjitetshme, së cilës i detyrohet dhe mban përgjegjësi shoqëria e sotme shqiptare.

**NJOHJA NXIT STUDIMIN**

*\*Studime në kuadër të në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH, ASA, ISKPK, "Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1944-1990", tetor 2018 dhe konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP dhe Muzeut Kombëtar Historik "Fytyra e "Armikut të Popullit", maj 2019.*



## **Persekutorët përballë të persektuarve, pas rrëzimit të komunizmit**

**Roland Qafoku**

Pas 28 vjetësh, mund të themi se për ne shqiptarët rrëzimi i komunizmit ka qenë një zjarr i shuar keq. Një nga arsytet më të rëndësishme është mungesa e njohjes së atij sistemi dhe media ka pasur dhe ka rolin e vet në këtë histori. Gazetari amerikan Arthur Hays Sulzberger (botues i New York Times nga 1935 në 1961) ka thënë: "Gjykimi i njeriut nuk mund të jetë më i mirë se informacioni që merr. Jepini atij të vërtetën dhe ai do ecë drejt". Mbështetur mbi këtë idiomë, në karrierën time kam qenë shumë i tërhequr nga figurat e sistemit komunist. Natyrisht unë rrezikoja të paragjykohesha dhe të gjykojesha nga një pjesë e publikut, por gjithnjë kam këmbëngulur ta njoh sa më mirë atë sistem nëpërmjet një rruge që është pjesë e profesionit tim: duke i intervistuar personazhet e atij sistemi dhe

jo duke u qëndruar larg atyre. Nëse nuk do ta kisha bërë do ta njihja shumë pak atë sistem dhe, natyrisht, jo siç e njoh tani.

Sa më mirë ta njohësh diktaturën, aq më mirë e ndërton demokracinë. I bindur se e vërteta gjendet në përplasjen dhe ballafaqimin e shumë burimeve, deklaratave, prononcimeve dhe dokumentimin e tyre, unë do përpiqem të sjell sot dhe të vendos përballë njëri-tjetrit personazhe të diktaturës komuniste me personazhe të cilët u persekutuan nga regjimi komunist. Është një punim i bazuar mbi punën time si gazetar në 22 vjet e cila më ka dhënë mundësinë të intervistoj dhe bisedoj me personazhe të regjimit komunist, por edhe me viktimat e tyre.

Besoj se është shumë interesante dhe e vlefshme të intervistosh Nexhmije Hoxhën, por edhe Ajnëshah Vlorën; Ramiz Alinë, por edhe Leka Zogun; Hekuran Isain, por edhe Ismail Kadarenë dhe kështu me radhë. Besoj se kështu kupton më qartë se çfarë ka ndodhur gjatë sistemit komunist dhe si e percepton shoqëria shqiptare në ditët e sotme atë që ka ndodhur gjatë asaj kohe.

Kemi 28 vjet që ndërtojmë demokracinë si shoqëri dhe që mjekojmë plagët e marra në 46 vjet komunizëm dhe mund të themi se ende si shoqëri nuk na ka dalë narkoza e komunizmit.

Rrjedhimisht, jo vetëm për brezin e ri, por edhe për ata që kanë jetuar edhe në regjimin komunist dhe jetojnë edhe sistemin demokratik, janë një aradhë me pyetje, përgjigjet e të cilave tregojnë shumë: A kanë ndryshuar qëndrimet e ish funksionarëve të regjimit pas rrëzimit të diktaturës? A janë penduar personazhet e diktaturës, por edhe fëmijët e tyre? Cili është qëndrimi i tyre përballë personazheve që janë persektuar? A shërben vazhdimi i glorifikimit të rezistencës së Luftës së Dytë Botërore për të përligjur sistemin komunist?



## **Diktatura nga këndvështrimi i të prekurve: roli i familjes**

**Blerina Këllezi, Aurora Guxholli**

Regjimi komunist në Shqipëri zgjati më shumë se 45 vite dhe pati viktimat në më shumë se një gjeneratë. Krimet e regjimit komunist përfshijnë ndër të tjera vrasje pa gjyq, burgime, internime, mungesë mbrojtjeje ligjore në gjyqe dhe shumë shkelje të së drejtave të tjera të karakterit politik, civil, por dhe ekonomik, social dhe kulturor.

Shembuj të këtyre shkeljeve të të drejtave përfshijnë të drejtën e punës, të arsimimit, të mbrojtjes shëndetësore, të drejtën e strehimit, lëvizjes së lirë, lirisë së fjalës, lirisë së besimit e shumë të tjera. Shumë nga këto shkelje janë dokumentuar qartë në literaturën shqiptare dhe atë botërore (p.sh. Lleshanaku & Tufa, 2014, 2015, 2016, 2017). Ndërkohë, ka pak studime psikologjike mbi pasojat e këtyre krimeve.

Në aspektin psikologjik, këto lloj krimesh shoqërohen me vështirësi shumë të mëdha dhe jo rrallë mund të lënë pasoja te viktimat e tyre. Pavarësisht nivelit të dhunës, jo çdokush vuan nga pasoja psikologjike të përhershme, të tilla që pengojnë rikthimin në jetën e mëparshme. Kjo ndodh sepse aftësia për t'i mbijetuar traumës varet nga shumë faktorë. Studimet psikologjike tregojnë se pasojat e traumës varen nga kuptimi që individët i japin asaj (p.sh. çështje ideologjike), prania e mbështetjes së familjes dhe miqve (në të tashmen dhe të ardhmen), reagimi i të tjerëve pas ngjarjes (p.sh. heshtja ndaj dhunës seksuale) si dhe nga çfarë ndodh pas ngjarjes (p.sh. ndryshimet ligjore, shoqërore etj.). Asnjë nga këto procese nuk ndodh në nivel individual. Ato varen nga prania e të tjerëve dhe mënyra sesi individ i ndërvepron me të tjerët. Ky punim i qaset traumës si fenomen shoqëror bazuar në teorinë e identitetit social...



## Kur artisti shpallej “armik i popullit”

Dr. Suzana Varvarica Kuka

“Socializmi sipas modelit nordik ku vepron demokracia e sotme sociale pranon se: “në një shoqëri socialiste, kahu komunist e konsideron dhe e vendos komunitetin njerëzor në krye të referimeve ideologjike.”

Mbi një shoqëri në diktaturë, kjo e fundit ndërtohet “...në pushtetin totalitar të diktatorit”. Ndërsa një shoqëri nën

diktaturën komuniste “... jeton në sistemin e kontrolluar prej pushtetit absolut të diktatorit komunist, i cili qeveris çdo qelizë të shoqërisë dhe kontrollon jetën e çdo individit”. Sistemi një partik në Shqipëri mbahej nga tri boshte kryesorë: diktatura e proletariatit, lufta e klasave dhe edukimi komunist. Ata mbanin aureolën e PPSH, e cila në brendësi kishte figurën unike të diktatorit. Sistemi kontrollohej e ruhej nga arma e Sigurimit të Shtetit dhe ecte përpara nga mega-makina ideo-kulturore, që kishte ingranazh kryesor lëvizës metodën e Realizmit Socialist...”





**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

---

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës  
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë  
<http://www.autoritetidoshjeve.gov.al>